

KËRKESË
Nr. 324/4, datë 6.4.2020

PËR SHPRONËSIM ME INTERES PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, shpall kërkesën për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të llojit tokë truall dhe ndërtesë që preken nga realizimi nga realizimi i objekteve “Rikostruksioni i shkollës ‘Thanas Bozo’, ndërtimi i palestrës dhe terrenet sportive Kolonjë”, Bashkia Lushnje. Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Lushnje.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private (sipas tabelës bashkëlidhur), të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur në bazë të VKM-së nr. 89, datë 3.6.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” dhe të VKM nr. 138 dt. 23.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së sasës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes Ppublik”, i ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, si dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit dhe marrjes në përdorim të përkohshëm. Lutemi pronarëve dhe personave që pretendojnë pronësinë mbi pasuritë që preken nga ky projekt, të dorëzojnë çdo dokument që disponojnë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnje, mbi saktësimin dhe konfirmimin e pronësisë, sipërfaqeve, mungesat e dokumentacionit etj.

Vlera totale e shpronësimit është 1,930,435 (një milionë e nëntëqind e tridhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
DHE KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Artan Shkreli

Lista e pronarëve të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i objektit
“Rikostruksioni i Shkollës ‘Thanas Bozo’, Ndërtimi i Palestrës dhe Terrenet Sportive Kolonjë”

Nr	ZK	Nr. i Pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqja truallit (m ²)	Cmimi i truallit (lekë/m ²)	Vlera truallit (lekë)	Sip. Ndërtesës (m ²)	Cmimi i ndërtesës (lekë/m ²)	Vlera ndërtese (lekë)	Vlera totale truall dhe ndërtesë (lekë)	Shënime
1	2207	3//36	Kolonjë Lushnje	Asqeri Çela	100	451	45,100	74	Me situacion	1,885,335.0	1,930,435.0	Shkresa nr. 7272/1 prot. dt. 11/09/2019; Vërtetim Hipotekor dt. 07/08/2019
Total											1,930,435	

Shënime:

- Për truallin, cmimi i llogaritur është marrë nga VKM nr. 89, dt.03.02.2016 “Për miratimin e Hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.
- Për ndërtesën, vlera është llogaritur sipas përcaktimeve të VKM nr. 138 dt. 23.03.2000 “Për Kriteret Teknike të Vlerësimit dhe të Përlllogaritjes së Masës së Shpërblimit të Pasurive Pronë Private që Shpronësohen, të Pasurive që Zhvlerësohen dhe të të Drejtave të Personave të Tretë, për Interes Publik”, i ndryshuar, ku çmimet janë marrë nga Enti Kombëtar i Banesave.